



# 20 vite Drejtoria për siguri të informatave të klasifikuara

5 mars 2004 - 5 mars 2024

Shkup, mars 2024

## Drejtoria për siguri të informatave të klasifikuara

Me vendosmërinë e shprehur për integrim në strukturat euroatlantike, atëherë, Republika e Maqedonisë, i ndërmerr hapat e duhura për t'u afruar kah NATO dhe BE, që nënkuptonte vendosjen e bashkëpunimit me këto organizata ndërkombëtare edhe në fushën e sigurisë, me atë, edhe fillimin e shkëmbimit të informatave të klasifikuara dhe mbrojtjen e tyre, reciproke. Në nëntor, viti 1995, me nënshkrimin e Dokumentit kornizë për qasje kah programi i NATO -s, Partneritet për paqe, dhe duke u bë anëtare e Këshillit veri - atlantikë për bashkëpunim, më vonë, Këshilli euro – atlantik, partner, një nga detyrat e shtetit ishte të hap zyrë përfaqësuese në Bruksel dhe organet përkatëse në vendin për vendosjen e bashkëpunimit të drejtpërdrejt me NATO – on. Me këtë qëllim, në janar viti 1996, nëpërmjet shkëmbimit të letrave është arrit marrëveshje e sigurisë midis Republikës së Maqedonisë dhe NATO - s me të cilën përcaktohen masat e sigurisë dhe obligimet e ndërsjella gjatë realizimit të bashkëpunimit të sigurisë. Rrjedhimisht, në qershor, viti 1996 në Zyrën e NATO -s në Bruksel, është hapur, Zyre për lidhje, ndërsa në fund të vitit 1997 edhe Misioni i përhershëm i Republikës së Maqedonisë pranë NATO -s, ndërsa në kuadër të Ministrisë së mbrojtjes është formuar Shërbimi për siguri reciproke për mbrojtjen e informatave që janë të shkëmbyera deri te përdoruesit e fundit, në Shërbimin është formuar Regjistri qendror, ndërsa në Ministrinë për punë të brendshme dhe Ministrinë për punë të jashtme janë formuar nën - regjistrat e parë për të gjitha informatat e klasifikuara.

Me atë u krijuar mundësi për përparimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me NATO -n, i cili në prill 1999 rezultoi me atë që Republika e Maqedonisë arriti statusin e vendit aspirant për anëtarësim në Aleancën dhe filloi me përgatitjen dhe realizimin e Planit aksionar për anëtarësim. Në pajtim me obligimet e pranuar për atë qëllim dhe obligimet që dalin nga Qëllimet e partneritetit në kornizë të anëtarësimit në Programin Partneritet për paqe, në mars vitit 2002 me Vendim të Qeverisë të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e RM", nr. 21/02) është formuar, Autoriteti nacional i sigurisë i Republikës së Maqedonisë në kontekst të NATO-s (ANS) si shërbim profesional i Qeverisë. NATO, e përshëndeti përparimin e Shërbimit me vërejtje se edhe më tutje duhet të zhvillohet me qëllim që me sukses ti kryej detyrat e saj dhe te jetë financiarisht e pavarur. Në atë drejtim, Qeveria e atëherëshme, solli vendim për ndryshime në sektorin e sigurisë të lidhura me shkëmbimin dhe menaxhimin me informata që kanë karakter të ndjeshëm ose të fshehtë, dhe të cilët ishin në drejtim të sjelljes së ligjit të posaçëm me të cilin do të rregullohet mbrojtja e informatave të klasifikuara në vend.

Termi „informata të klasifikuara” herën e parë zyrtarisht u përdor në rregulloren nacionale nëpërmjet Ligjit për informata të klasifikuara ("Gazeta zyrtare e RM", nr. 9/04) i cili hyri në fuqi më 5 mars viti 2004 dhe me të cilën shërbimi i mëhershëm qeveritar, Autoriteti nacional i sigurisë, kaloi në Drejtoria për siguri të informatave të klasifikuara, si organ i pavarur i administratës publike në cilësinë e personit juridik.

Gjatë përgatitjes së Ligjit u shfrytëzuan përvojat nga Sllovenia dhe Republika Çeke, ndërsa ishte e konsultuar edhe Zyra për siguri e NATO -s. Në pajtim me ligjin, në nëntor viti 2004 u sollën Rregullorja për siguri administrative të informatave të klasifikuara, Rregullorja për siguri fizike të informatave të klasifikuara dhe Rregullorja për siguri të personave përdorues të informatave të klasifikuara ("Gazeta zyrtare e RM", nr. 82/2004), ndërsa në mars viti 2005 u

## Drejtoria për siguri të informatave të klasifikuara

sollën Rregullorja për siguri industriale për informata të klasifikuara dhe Rregullorja për siguri informatike për informata të klasifikuara ("Gazeta zyrtare e RM", nr. 16/2005). Pastaj u sollën edhe akte të brendshme juridike të lidhura me mbrojtjen e informatave të klasifikuara sipas standardeve të sigurisë të NATO -s dhe BE -së, me të cilën u mbyll korniza juridike për mbrojtjen e informatave të klasifikuara.

Si rezultat i përcaktimit për integrimin euroatlantik të vendit dhe përcaktimin e anëtarësimit të plotë në Bashkimin evropian si një nga qëllimet nacionale strategjike, në prill, viti 2001 është nënshkruar, Marrëveshja për stabilizim dhe asociacion në BE. Marrëveshja e cila i caktoi bazat e bashkëpunimit më të thellë dhe strukturor në sfera të shumta, duke e përfshirë edhe sigurinë, hyri në fuqi më 2004, një vit më vonë vendi arriti statusin, vendi - kandidat për anëtarësim në Bashkimin evropian, që hapi perspektiva dhe horizonte të reja, duke përfshirë edhe pjesëmarrje në programet dhe në politikat e përbashkëta të Bashkimit. Në atë periudhë, në mars viti 2005, drejtori i Drejtorisë, në emër të Qeverisë e nënshkroi Marrëveshjen me BE, për procedurat e sigurisë për shkëmbimin e informatave të klasifikuara ("Gazeta zyrtare e RM", nr. 56/2005), në maj vitin e njëjtë, ishin të realizuara marrëveshjet e sigurisë për mbrojtje dhe ruajtjen e informatave të klasifikuara të shkëmbyera me BE. Marrëveshja hyri në fuqi në korrik 2005 dhe me atë u hap mundësia për bashkëpunim më të ngushtë i Drejtorisë me Zyrën për siguri pranë Sekretariatit gjeneral të Bashkimit evropian, e cila në vitet që vinin manifestohet nëpërmjet shumë vizitave, takime dhe lloj tjetër të bashkëpunimit bilateral në vend dhe në institucionet e BE në Bruksel.

Përcaktimi strategjik i vendit për përparimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal në fushën e sigurisë e hapi rrugën për Drejtorinë kah kontaktet e ngushta me shërbimet e njëjta në rajon. Si rezultat i asaj në tetor 2006 ishte arritur Marrëveshja për shkëmbimin dhe mbrojtjen reciproke të informatave të klasifikuara me Bullgarinë, në nëntor viti i njëjtë u arrit Marrëveshja me Shqipërinë. Në periudhën prej 2008 deri vitin 2021 Drejtoria realizon shume aktivitete të lidhura me rregullimin e marrëveshjes bilaterale me shtete të huaja në nivel të Qeverisë. Në ndërkohë u arritën gjithsej 20 marrëveshje bilaterale: me Republikën Çeke ( në gusht 2008) me Republikën Sllovaqe ( nëntor 2008), me Kroacinë ( nëntor 2008), me Estonin ( nëntor 2008), me Sllovenin (mars 2008) ,me Francën (korrik 2010), me Gjermanin (korrik 2012), me Serbin (shkurt 2014), me Bosnjën dhe Hercegovinën ( maj 2014), me Hungarinë (korrik 2014),me Spanjën ( nëntor 2014), me Italinë (maj 2016), me Rumunin (gusht 2018), me Austrinë (qershor 2018), me Luksemburgun (shtator 2018), me Malin e Zi (maj 2019), me Greqinë (janar 2021) dhe me SHBA (dhjetor 2021).

Nevoja për vënien e kontrollit mbi menaxhimin dhe mbrojtjen jo vetëm të informatave të klasifikuara të huaja por edhe informatat e klasifikuara nacionale, si dhe për vendosjen e mbikëqyrjes inspektuese mbi të gjithë organet shtetërore dhe personave tjerë fizik dhe juridik për zbatim të mirëfilltë të Ligjit për informata të klasifikuara rezulton me Ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për informata të klasifikuara ("Gazeta zyrtare e RM", nr. 113/07) në shtator viti 2007.

Pa ciklit të ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për informata të klasifikuara ("Gazeta zyrtare e RM", nr. 145/2010, 80/2012, 41/2014, 21./2018), u vërtetua nevoja për sjelljen e

## Drejtoria për siguri të informatave të klasifikuara

rregullores së re ligjore e cila do ti përcjell trendët aktuale në menaxhimin me informata të klasifikuara. Me atë qëllim, në nëntor 2019 u soll Ligji i ri për informata të klasifikuara(\*) klasifikuara ("Gazeta zyrtare e RM", nr. 275/19) në të cilin është kryer transpozimi i Vendimit të Këshillit nga 23 shtator 2013 në lidhje me rregullat për siguri për mbrojtje të informatave të klasifikuara të BE (CELEX3201D0488). I përpunuar në bazë të përvojave praktike në punën me informata të klasifikuara, vendimi i ri ligjor më preciz e rregullon sistemin për mbrojtje të informatave të klasifikuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mundëson nivel të lartë të pajtueshmërisë me politikat e sigurisë të NATO -s dhe BE -së dhe i rregullon pyetjet nga sfera të tjera të cilat ngushtë janë të lidhura me sigurinë e informatave të klasifikuara. Në bazë të ligjit që u soll gjatë vitit 2020 dhe 2021 u sollën më shumë akte nën ligjore dhe forma të rregulloreve nga sfera e sigurisë të personave përdorues të informatave të klasifikuara dhe nga sfera e mbikëqyrjes inspektuese, përderisa në korrik 2022 u soll Rregullorja e re për persona përdorues të informatave të klasifikuara, ndërsa në tetor 2023 u soll edhe Rregullorja e re për siguri administrative për informata të klasifikuara dhe të informatave me përdorim të kufizuar. Në ndërkohë, u sollën më shumë akte të brendshme nga sfera e kompetencave të Drejtorisë si organ vetëqeverisës i administratës publike.

Duke ecur në drejtim të proceseve euroatlantike integruese të Qeverisë, Drejtoria ndër merr hapa për përforsimin e rolit të vet në korniza të strukturës së sigurisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në këtë kontekst është edhe prezenca e vazhdueshme e të punësuarve të Drejtorisë, në korniza të misioneve pranë NATO – s dhe BE – së në Bruksel nga viti 2008 deri më sot, me çka jepet kontribut në përpjekjet e përgjithshme nacionale për marrjen e anëtarësimit të plotë në organizatat ndërkombëtare dhe përforsimi i pozicionit të shtetit në planin ndërkombëtar.

Drejtoria është pjesëmarrës aktiv në forumet rajonale dhe multinacionale për bashkëpunim në sferën e mbrojtjes të informatave të klasifikuara. Një nga ato është Forumi i autoriteteve nacionale të sigurisë i vendeve nga Evropa juglindore (SEENSA) në të cilën Drejtoria në mënyrë aktive është e përfshirë nga formimi i tij deri sot, dhe në atë periudhë dy herë, në 2015 dhe 2022, ishte kryesues dhe mikpritës i takimeve vjetore të drejtorëve të autoriteteve nacionale të sigurisë që u mbajtën në Shkup, ndërsa në vitin 2023 ishte ko-organizator dhe mikpritës i takimit që u mbajt në Ohër. Është i vërejtur angazhimi i Drejtorisë edhe në korniza të bashkëpunimit ndërmjet drejtorëve të autoriteteve nacionale të sigurisë të vendeve nga republikat e mëhershme të Jugosllavisë (format 6S), ndërsa bashkëpunimi i suksesshëm me shërbimet partner nga rajoni sidomos reflekton edhe në nivelin bilateral nëpërmjet realizimit të shumë takimeve në nivel të drejtorëve dhe të ekspertëve si dhe nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të tjera me interes të përbashkët. Drejtoria merr pjesë në realizimin e Grupit të punës multinacionale për siguri industriale (MISWG) në të cilin arriti statusin e vendit ,mbikëqyrës, ndërsa nga janari 2023 edhe me status të anëtares së plotë

Si rezultat i vendosjes së relacioneve me shërbimet nga vendet partner dhe bashkëpunimi në forumet multinacionale, përfaqësues të Drejtorisë marrin pjesë në aktivitete që organizohen në vend dhe jashtë vendit, të cilët përpunojnë tema nga sfera e sigurisë të informatave të klasifikuara, por edhe në përbashkëpunim me sfidat e sigurisë në kuptim më të gjerë.

## Drejtoria për siguri të informatave të klasifikuara

Në këtë kuptim, Drejtoria merr pjesë në aktivitete të organizuara nga Qendra evropiane për studime të sigurisë, Xhorxh Marshall nga Garmishparenkirhen nga Gjermania, nga Këshilli rajonal për bashkëpunim (RCC) nga Sarajeva dhe realizon bashkëpunim të suksesshëm me Zyrën për bashkëpunim në mbrojtje pranë Ambasadës të SHBA në Shkup. Gjithashtu, Drejtoria realizon bashkëpunim të suksesshëm edhe me Zyrën e qendrës së Zhenevës për menaxhim me sektorin e sigurisë (DCAF) në Shkup me mbështetjen e së cilës janë realizuar shume projekte me rëndësi të madhe për realizimin e qëllimeve dhe detyrave të Drejtorisë.

Arritja e statusit, anëtare e plotë e NATO -s e Republikës së Maqedonisë së Veriut krijon detyra dhe obligime për Drejtorinë edhe në pikëpamje të pjesëmarrjes në punën e Komitetit të NATO -s për siguri dhe dhënien e kontributit në përpunimin e akteve nga sfera e politikës së sigurisë të NATO -s. Lidhur me obligimet dhe aktivitetet që dalin nga anëtarësimi në NATO, drejtori i Drejtorisë është një nga anëtarët e Këshillit për koordinim të aktiviteteve të lidhura me anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO, me të cilën kryeson kryeministri i Qeverisë, ndërsa përfaqësues të Drejtorisë janë aktiv të përfshirë në punën e Komitetit punues të eksperteve i cili funksionon në mbështetje të Këshillit.

Në lidhje me obligimet të cilët merren në nivel nacional në pikëpamje të arritjes së anëtarësimin të plotë në Bashkimin evropian, Drejtoria merr pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet e lidhura me këtë kapitull 31 – Politika e jashtme e sigurisë dhe e mbrojtjes nga Programi nacional për përvetësimin e të drejtës të Bashkimit evropian (NPAA). Drejtoria ka vendosur relacione dhe bashkëpunim me Zyrën për siguri të Sekretariatit gjeneral të Këshillit të BE -s dhe me Komisionin evropian nëpërmjet së cilës disa herë, në bashkëpunim me shërbimet partner të vendeve anëtare të BE -së, janë të shfrytëzuara mundësitë e TAEX instrumentit për realizim të vizitave studimore, punëtori dhe misione eksperte në vend dhe jashtë vendit.

Në 20 vitet e kaluara, nga formimi deri sot, Drejtoria për siguri të informatave të klasifikuara, në bazë të kompetencave të saj dhe në bazë të planeve për zhvillim, ka realizuar shume projekte dhe aktivitete të lidhura për përparimin e sistemit për mbrojtje të informatave të klasifikuara në vend. Gjatë kësaj Drejtoria vazhdimisht merr pjesë me ndihmë profesionale në përpunimin e akteve të brendshme dhe udhëzimeve për punë me informata të klasifikuara të organeve shtetërore dhe ndërmarrjeve private tek të cilët është e vërtetuar nevoja e atillë. Merr iniciativë për sjelljen e marrëveshjeve bilaterale me shtete të tjera, organizon seminare dhe trajnime për përdoruesit informatave të klasifikuara. Për punën e vet, Drejtoria rregullisht e informon Qeverinë nëpërmjet Raportit vjetor i cili shpallet në faqen zyrtare, ndërsa për transparencën e saj në lidhje me informimin e publikut, në pajtim me Agjencinë për mbrojtje të së drejtës të qasjes së lirë deri te informatat me karakter publik nga 2022 për transparencën e institucioneve shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Drejtoria është e radhitur si institucion me nivel të lart të transparencës.